



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
KËSHILLI TEKNIK

Nr. 364 Prot.

Tiranë, më datë 15.07 2026

**VENDIM**

**Nr. 104, datë 15.07.2026**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe në Vendimin e KKTKM-së, Nr. 75 datë 19.02.2020 “Për miratimin e llojeve të ndërhyrjeve me karakter mirëmbajtës të pasurive kulturore, sipas listës bashkëlidhur”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektit, në mbledhjen e datës 15.07.2026, Këshilli Teknik:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e Raportit të vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor hartuar në kuadër të projektit “Linja elektrike 110 KV dhe nënstacioni ngritës Qarr-Kozel 110/35 KV”, qarku Korçë, me zhvillues bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Albpower”, sh.p.k., “Favina”, sh.p.k., dhe “Favina 1”, sh.p.k.:
2. Investitori duhet të lidhë akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për realizimin e sondazheve arkeologjike për projektin “Linja elektrike 110 KV dhe nënstacioni ngritës Qarr-Kozel 110/35 KV”, si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt, e më pas subjekti aplikues mund të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Para zbatimit të punimeve të realizohet sondazh arkeologjik në shtyllën 24 nga DSHA dhe rezultati të paraqitet për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

